



IEKA

KOMITETI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Raport Vjetor 2019

6 Gusht 2020

Përgatitur nga:
Elida Miti, Sokol Toska

Përgatitur për:
Asamblenë e Përgjithëshme IEKA

Përmbajtja e Lëndës

I. INFORMACION JURIDIK DHE ORGANIZATIV.....	3
I.i. ORGANET E QEVERISJES.....	3
I.ii. ORGANI MBIKËQYRËS.....	5
I.iii. KOMITETET DHE KËSHILLAT.....	5
II. VEPRIMTARIA FINANCIARE.....	8
II.i. PROCEDURAT KONTABËL.....	9
II.ii. PAJTUESHMËRIA E LLOGARIVE ME BUXHETIN.....	11
II.iii. KORREKTËSIA E LLOGARIVE TË APROVUARA NGA KD.....	16
II.iv. KOMENTE MBI SITUATËN FINANCIARE.....	16
III. KONSTATIME DHE REKOMANDIME.....	17
IV. ORGANIGRAMA IEKA.....	19

I. INFORMACION JURIDIK DHE ORGANIZATIV

Emri: Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Statusi juridik: Organizatë jo fitimprurëse, shoqatë.

Selia: Rruga e Elbasanit, Pall Edil Al-It, kati 3, Tiranë.

Themeluar: Me vendim gjykate nr 3573, datë 16 tetor 1998.

Themeluesit: Grupim profesional i Audituesve Ligjorë dhe Shoqërive të Auditimit që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë: Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ka për objekt të veprimtarisë të sigurojë ushtrimin e profesionit të audituesve ligjorë në përputhje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij.

I.i. ORGANET E QEVERISJES

Organi më i lartë vendimmarrës. Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

Organi Drejtues. Këshilli Drejtues i IEKAs përbëhet nga shtatë anëtarë, katër nga të cilët janë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme me mandat nga 1 tetor 2019 – 1 tetor 2023 dhe tre anëtarët e tjerë të zgjedhur me short të cilët e kanë mandatin nga 1 tetor 2019 – 1 tetor 2021. Këshilli Drejtues në mbledhjen e datës 1 tetor 2019 ka zgjedhur Kryetarin dhe zv/Kryetarin e tij.

Këshilli Drejtues ka përbërjen e mëposhtme:

	<u>Pozicioni</u>	<u>Afati i Mandatit</u>
Zj. Eleonora OLLI	Kryetar	Shtator 2023
Z. Arqile MISHTAKU	Zv/Kryetar	Shtator 2021
Z. Bujar OSMANI	Anëtar	Shtator 2021
Z. Shkëlzen MARGJEKA	Anëtar	Shtator 2021
Z. Berti PASHKO	Anëtar	Shtator 2023
Zj. Rezarta KOÇOLLARI	Anëtar	Shtator 2023
Z. Elton TIRANA	Anëtar	Shtator 2023

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABEL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2019

Gjatë vitit 2019 Këshilli Drejtues është mbledhur 12 herë dhe kostot e mbledhjeve arrijnë shumën 1 035 000 lekë, ndërsa honoraret e Këshillit Drejtues kanë një vlerë vjetore 3 000 000 lekë. Gjithashtu, është shpenzuar edhe fondi i rezervës së Këshillit të Drejtimit në vlerën 300 000 Lekë me destinacion “*Ndihmë për familjet shqiptare të prekura nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019*”.

Organi Ekzekutiv. Drejtori i zgjedhur dhe miratuar nga Këshilli Drejtues është Znj. Elvira Hoxha sipas vendimit nr. 43 të datës 20.09.2017. Gjithashtu, në kryerjen e aktiviteteve IEKA ka staf administrativ, i cili ka përbërjen më poshtë:

1. Elvira Hoxha - Drejtor Ekzekutiv
2. Elda Luga - Specialist Edukimi
3. Valentina Sora - Specialist Edukimi dhe Financë Kontabiliteti
4. Tedi Ziko - Specialist, Standardet profesionale
5. Sara Shurdhi - Specialist, Standardet profesionale
6. Eralda Kullolli - Sekretare, Arkëtare
7. Albana Pllaha - Mirëmbajtje (pastrim) të ambjentëve

Shpenzimet për pagat gjatë vitit 2019 ka qenë 5 667 762 Lekë, për stafin ekzekutiv dhe personelin me kohë të plotë, dhe 570 000 Lekë për personelin me kohë të pjesëshme.

Kontrolli i Brendshëm. Komiteti i Kontrollit të Brendshëm (Komiteti i Auditimit), i zgjedhur nga Asambleja e përgjithshme e datës 30 Shtator 2019, përbëhet nga:

	<u>Pozicioni</u>	<u>Afati i Mandatit</u>
Zj. Elida MITI	Kryetar	Shtator 2023
Z. Sokol TOSKA	Anëtar	Shtator 2023

Organizimi dhe funksionimi i KKB rregullohet nga nenet 8 dhe 9 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar si dhe nga nenet 24 dhe 25 të statutit të organizatës IEKA.

Gjatë vitit 2019 ky komitet ka kryer një mbledhje në ambientet e IEKA në datën 17 Tetor 2019, e cila është konsideruar si mbledhje konstituimi i këtij komiteti të ri. Ky komitet nuk ka marrë honorare gjatë vitit 2019, ndërsa komiteti i mëparshëm ka qenë përbërë nga Z. Luan Muca dhe Znj. Vjollca Dervishi. Honoraret e komitetit të mëparshëm për periudhën 2019 kanë qenë në shumën 180.000 Lekë.

I.ii. ORGANI MBIKËQYRËS

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, organizimi i të cilit është rregulluar mbi bazën e ligjit 10091 datë 05.03.2009 (i ndryshuar) si dhe me VKM nr. 786 date 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të BMP”.

Përbërja e këtij bordi është si vijon:

	<u>Pozicioni</u>	<u>Afati i Mandatit</u>
Z. Dritan FINO	Kryetar	Mars 2021
Zj. Adriana BERBERI	Anëtar	Mars 2021
Z. Luan ABAZI	Anëtar	Mars 2021
Zj. Edlira LUCI	Anëtar	Mars 2021
Z. Klement MERSINI	Anëtar	Mars 2021

Përbërja e Bordit të Mbikëqyrjes Publike është miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 27, datë 24.03.2017. Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave, me një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë.

I.iii. KOMITETET DHE KËSHILLAT

IEKA ushtron të drejtat dhe detyrimet ligjore dhe statutore dhe krijon komitete të cilat emërohen nga Këshilli Drejtues dhe të organizuara mbi bazën e parashikimeve ligjore dhe statutore. Aktualisht funksionojnë shtatë komitete dhe këshilla, të cilat i përshkruajmë në vijim:

(1) **Komiteti i Regjistrimit**, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, me Kryetar Bujar Osmani dhe anëtarë, Elvira Hoxha, Kesjana Halili, Leze Abazi, Heralda Jahollari, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë për një periudhë katërvjeçare. Organizimi i këtij autoriteti është rregulluar në bazë të nenit 5, 19 dhe 60 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar si dhe me Rregulloren për

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2019

Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Regjistrimit pranë IEKA, të propozuar nga IEKA dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.

Gjatë 2019 ky komitet është mbledhur 7 herë duke përdorur shumën prej 381 000 lekë nga buxheti i parashikuar.

(2) Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës, i cili përbëhet nga 3 anëtarë, me Kryetar Shkëlzen Margjeka dhe anëtarë Majlinda Maqellari dhe Elton Tirana. Organizimi i këtij komiteti është rregulluar në bazë të neneve 12,14, 55, 57 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar si dhe me Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike. Gjatë vitit 2019 ky komitet është mbledhur 2 herë duke përdorur shumën prej 188 000 lekë nga buxheti i parashikuar.

(3) Komiteti i Kontrollit të Cilësisë, i cili përbëhet nga 4 anëtarë me kryetar Arqile Mishtaku dhe anëtarë Vera Lala, Erjon Pjetërnikaj dhe Brunilda Stefa. Organizimi i këtij komiteti është rregulluar në bazë të nenit 12, 38 dhe 39 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, te ndryshuar, nenit 15 të Statutit të IEKA-s si dhe me Rregulloren për Kontrollin e Cilësisë, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.

Gjatë vitit 2019 ky komitet nuk është mbledhur dhe nuk ka marrë honorare. Ky komitet nuk ka funksionuar pasi ka qenë në pritje të delegimit nga BMP, të kontrollit të cilësisë për Jo EIP.

(4) Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshem Profesional, i cili përbëhet nga 4 anëtarë me kryetar Rezarta Kocollari dhe anëtarë Kledian Kodra, Doranin Agalliu dhe Julian Naqellari. Organizimi i këtij komiteti është rregulluar në bazë të nenit 12 dhe 25 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar dhe të Statutit të IEKA-s, si dhe me Rregulloren e Edukimit dhe e Zhvillimit të Vijueshëm Profesional, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve. Gjatë vitit 2019 ky komitet është mbledhur 5 herë duke përdorur shumën prej 201 000 lekë nga buxheti i parashikuar.

(5) **Komiteti i Standardeve Profesionale**, i cili përbëhet nga 3 anëtarë me kryetar Berti Pashko dhe anëtarë Artan Xhiani dhe Hysen Çela. Organizimi i këtij komiteti është rregulluar në bazë të nenit 12 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009, të ndryshuar dhe të Statutit të IEKA-s.

Gjatë vitit 2019 ky komitet ka realizuar 2 mbledhje duke përdorur shumën prej 44 000 lekë nga buxheti i parashikuar.

(6) **Këshilli i Botimit të Revistës Kontabilitet & Auditim**, i cili përbëhet nga 5 anëtarë me kryetar Berti Pashko dhe anëtarë Orfea Dhuci, Elvira Hoxha, Fatjan Devija dhe Tedi Ziko.

Gjatë vitit 2019 ky komitet ka realizuar vetëm një mbledhje dhe duke përdorur shumën prej 20 000 lekë nga buxheti i parashikuar, ndërsa botimi i revistës ka kushtuar 50 400 lekë.

(7) **Njësia (Struktura) e Edukimit të Kandidatëve**, me Drejtues Hysen Çela dhe dy specialistët e edukimit, Elda Luga dhe Valentina Sora.

II. VEPRIMTARIA FINANCIARE

Veprimtaria e IEKA-s rregullohet si vijon:

- Ligji nr. 10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” të ndryshuar me ligjin 47/2016;
- Kuadri ligjor civil dhe ai për Organizatat jo-fitimprurëse;
- Statuti i IEKA-s.

Veprimtaria e IEKA-s konsiston në organizimin e profesionistëve në lidhje me ushtrimin e profesionit në përputhje me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe nderit të anëtarëve të tij, kualifikimin e vijueshëm profesional dhe njohjen me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Sipas Statutit të IEKAs anëtarët e Institutit paguajnë kuota të detyrueshme vjetore për anëtarësinë (neni 29.1 i Statutit).

Për vitin 2019 kuotat janë si më poshtë:

- Kuota fikse në shumën 70 000 lekë për çdo anëtar aktiv në profesion.
- Kuota fikse në shumën 8 000 lekë për çdo anëtar joaktiv në profesion.
- Kuota variabël 0,5% të qarkullimit total deri 8 milionë Lekë dhe 0,3% të qarkullimit total mbi 8 milionë Lekë.

Të ardhurat nga kuotat e ndryshme apo trajnimet e realizuara shërbejnë për të përballuar shpenzimet; për të kryer pagesat e honorareve të Këshillit Drejtues dhe të Komiteteve, kuotat për pjesëmarrje në organizatat ndërkombëtare; për pagat e personelit dhe për mbulimin e kostove të shërbimeve që IEKA merr nga të tretët në kryerjen e veprimtarisë së vet.

Veprimtaria e IEKA-s realizohet nëpërmjet organeve drejtuese dhe ekzekutive. Për të realizuar një veprimtari në përputhje të plotë me Ligjet rregullatore, Organet Drejtuese të saj kanë hartuar një rregullore të brendshme, ku përcaktohen me hollësi detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pozicion pune.

Më poshtë po përmendim funksionet e Sektorit të Financë - Kontabilitetit shkurtimisht, meqënëse edhe detyra e KKB fokusohet tek ky sektor.

Sektori i Financë kontabilitetit përbëhet nga vetëm një person, Znj. Valentina Sora dhe detyrat kryesore janë si vijon:

- Përgatit dhe i paraqet Drejtorit ekzekutiv treguesit kryesorë të projekt - buxhetit të Institutit, sipas aktiviteteve për periudha afatmesme dhe afatshkurtëra.
- Llogarit kostot sipas aktiviteteve të Institutit dhe bën regjistrimin e transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike në librat dhe regjistrat kontabël, në pajtim me politikat dhe bazën kontabël të aplikueshme ose të aprovuar nga Këshilli Drejtues;
- Llogarit pagat e punonjësve dhe shumat e honorareve të miratuara nga Këshilli Drejtues si dhe përgatit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për pagesat që IEKA ju bën të tretëve për shërbimet e përfituara;
- Llogarit masën e tatimit mbi të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për të gjitha pagesat sipas rastit që ju bëhen individëve;
- Përpilon dokumentacionin e pagesave për faturat dhe shërbimet e tjera, për pagesat e tatimeve mbi të ardhurat dhe të sigurimeve shoqërore të punonjësve të IEKA-s; etj., të ngjashme;
- Përgatit raportet financiare mujore e tremujore dhe bën analizat përkatëse, të cilat ja paraqet Drejtorit Ekzekutiv;
- Përgatit pasqyrat financiare vjetore dhe propozon përmirësime në politikat kontabël të përdorura apo në formatet e raportimit në varësi me nevojat e drejtimit dhe të ndara sipas aktiviteteve ku merr pjesë Instituti;
- Informon vazhdimisht për gjendjen financiare të Institutit Drejtorin Ekzekutiv dhe Kryetarin e Këshillit Drejtues të Institutit;
- Kontrollon gjendjen fizike të arkës dhe regjistrimet e bëra në librin e saj, verifikon gjendjen fizike të aktiveve afatgjata e afatshkurtëra dhe përgatit dokumentacionin ku regjistrohen të gjitha transaksionet apo regjistrimet kontabël që ndikojnë në këto aktive, jo më pak se një herë në muaj;
- Bën rakordimin e kontributeve me detyrimet e anëtarëve duke u bazuar në të dhënat e kontabilitetit dhe të dhënat e vetë deklarimeve të bëra prej tyre.

II.i. PROCEDURAT KONTABËL

Organi Ekzekutiv i IEKA-s ka ndërtuar sistemin e regjistrimeve në kontabilitet, sipas parimeve dhe metodave të njohura kontabël, të cilat janë në përshtatje me Ligjin “Për Kontabilitetin” si dhe në funksion të dhënies së informacioneve mbi realizimin e zërave të parashikuara në buxhetin e miratuar.

Kryerja e shpenzimeve realizohet mbi bazën e domosdoshmërisë së tij, me qëllimin e përdorimit sa më me efektivitet të burimeve.

Çdo shpenzim shoqërohet me dokumentacion bazë justifikues, autorizohet dhe miratohet nga personat përgjegjës.

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2019

Drejtori Ekzekutiv autorizon shpenzimet e buxhetuara si dhe veprimet që lidhen me pagesat apo tërheqjet nga llogaritë bankare të IEKA-s, brenda kufijve të përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

Blerjet me lekë në dorë verifikohen nga Specialisti i Financës dhe paguhen nga Arkëtari dhe në çdo rast kanë tre firma, përfshirë nënshkrimin nga Drejtori Ekzekutiv.

Organet ekzekutive planifikojnë që në fillim të vitit paraardhës buxhetin për blerjen e çdo lloj pajisje, materiali apo shërbimi. Janë zbatuar metodikat e llogaritjes së kostove sipas aktiviteteve të institutit, sic janë edukimi profesional hyrës dhe i vijueshëm, publikimet, etj.

Specialisti i Financës ndjek arkëtimin e kuotave fikse dhe variabël të anëtarëve, kuotave të kandidatëve si edhe të të ardhurave të tjera si kurse trajnimi, regjistrime të reja, botime, e të tjera.

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2019

II.ii. PAJTUESHMËRIA E LLOGARIVE ME BUXHETIN

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar realizimi i buxhetit për vitin paraardhës, Buxheti i planifikuar për vitin 2019 dhe realizimi i tij në vlerë absolute dhe në përqindje përkundrejt buxhetit të planifikuar.

Zerat e Buxhetit		Realizimi Buxhetit 12M 2018	Buxheti i miratuar 2019	Realizimi Buxhetit 12M 2019	% ndaj Buxhetit
1	Burimet	27,125,637	23,800,000	30,834,133	130
1.1	Burime financiare	24,019,629	19,950,000	27,913,999	140
	Kuota fikse e anetaresimit	14,668,323	14,700,000	15,010,558	102
	Kuota variable e misioneve	7,303,790	4,000,000	8,331,243	208
	Te ardhura nga regjistrimi kandidatëve	1,000,000	750,000	2,850,000	380
	Te ardhura të tjera	1,047,516	500,000	1,722,198	344
	Te ardhura regj. në provime				
	Sponsorizime Konferenca 20 vjetori				
1.2	Burime të ardhurash të tjera	3,106,008	3,850,000	2,920,134	76
	Burime (te ardhura) nga Botimet	135,220	200,000	19,800	10
	Burime (te ardhura) kualif. kandidatë	1,407,500	1,200,000	790,500	66
	Burime (te ardhura) nga kualif. AL	135,000	1,500,000	122,000	8
	Burime nga trajnimi i SKK/SNK	1,060,000	600,000	1,532,000	255
	Te ardhura nga depozitat e kursimeve	351,285	350,000	445,694	127
	Fitime/humbje kurse kembimit	17,003		10,140	
2	Perdorime (Shpenzime)	29,190,846	30,471,820	29,934,594	98
2.1	Shpenzime nga veprimtaria	22,135,130	25,521,820	21,936,927	86
2.1.1	Pagat e punonjësve	5,467,312	8,705,820	6,243,762	72
	Pagat e personelit me kohe të plote	4,337,271	7,460,000	4,984,706	67
	Sigurime shoqërore	554,041	1,245,820	683,056	55
	Pagat personeli me kohe pjesëtime	576,000		576,000	
2.1.2	Honorare të Drejtimit	4,032,000	4,476,000	4,215,000	94
	Honorare Ant KD & Drejtimi përditsh.	3,000,000	3,000,000	3,000,000	100
	Pagese për mbledhje të KD	852,000	1,296,000	1,035,000	80
	Komiteti i Kontrollit të Brendshëm	180,000	180,000	180,000	100

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2019

Zerat e Buxhetit	Realizimi Buxhetit 12M 2018	Buxheti i miratuar 2019	Realizimi Buxhetit 12M 2019	% ndaj Buxhetit
2 Perdorime (Shpenzime vazhdim)	29,190,846	30,471,820	29,934,594	98
2.1.3 Honorare per Komitete	992,500	2,650,000	963,760	36
Komiteti i Regjistrimit	348,500	350,000	381,000	109
Komiteti i Investigimit & Disiplines	265,000	300,000	188,000	63
Komiteti i Edukimit te Kandidateve	124,000	300,000	201,000	67
Komiteti i Kualifikimit te Vjueshem	110,000	200,000		0
Komiteti i Kontrollit te Cilesise	145,000	1,200,000		0
Komiteti perkthim rishikim te Stand. Prof		200,000	149,760	75
Komiteti i Etikes, Standardeve Profesionale & te tjera		100,000	44,000	44
2.1.4 Shpenzime te Administrimit	11,643,318	8,190,000	8,952,865	109
Telefon, Fax, shpenzime interneti	211,185	300,000	190,418	63
Mirembajtja e regjistrimit publik & faqes inter.	99,600	200,000	99,600	50
Energji, Uje.	178,604	200,000	218,928	109
Kancelari, Shtypshkrime,riparime	160,262	400,000	199,860	50
Reklama, Publicitet, Njoftime		100,000	-	0
Abonime, Gazeta, revista		50,000	-	0
Udhetime e Djeta	2,210,529	2,200,000	1,880,583	85
Karburant e rip. te zakonshme	248,592	300,000	210,360	70
Taksa, sigurime e parkim automjetesh	268,486	250,000	168,781	68
Shpenzime pritjeje	190,838	200,000	91,228	46
Sherbime ne te trete	236,493	250,000	251,996	101
Regjistrime ne organet lokale	109,197	140,000	126,947	91
Shpenzime per kom. Bankare	89,051	100,000	97,090	97
Kuota anetaresimi Org. Nd/kombetare	2,057,168	2,000,000	1,787,618	89
Shpenzime te tjera	297,949	500,000	338,705	68
Shpenzime per Asamblene	1,096,183	800,000	800,849	100
Shpenzime Konferenca 20 Vjetori			-	
Auditimi i PF	151,380	200,000	210,000	105
Shpenzime amortizimi	2,168,801	-	2,039,902	
Shpenzime te paparashikuara	1,869,000	-	-	
Shpenzime Konsulence ligjore		-	240,000	
2.1.5 Investime, Meremetime	-	1,200,000	1,261,540	105
Investime (blerje AAM dhe merimetime)		1,200,000	1,261,540	105
2.1.6 Rezerve e KD gjithsej	-	300,000	300,000	100

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABEL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2019

Zerat e Buxhetit		Realizimi Buxhetit 12M 2018	Buxheti i miratuar 2019	Realizimi Buxhetit 12M 2019	% ndaj Buxhetit
2	Perdorime (Shpenzime vazhdim)	29,190,846	30,471,820	29,934,594	98
2.2	Shpenzime per botime	55,019	1,900,000	408,576	22
	Botimi i Revistes		600,000	70,400	12
	Shpenzime per botime te tjera	55,019	300,000	6,802	2
	Shpenzime Adoptimi, perkthimi dhe pershtatja - Programi Pack PEE dhe te tjera		1,000,000	331,374	33
2.3	Shpenzime per kualifikimin	3,022,416	3,050,000	3,389,486	111
	Shpenzime kualifikimi kandidate	1,249,090	1,400,000	1,656,010	118
	Shpenzime kualifikimi AL	1,262,562	1,200,000	942,132	79
	Shpenzime trajnimi i SKK/SNK	510,764	450,000	791,344	176
2.4	Fitime/humbje kursi kembimit	119,452		31,989	
2.5	Aktiviteti sipas vendimit Asamblese	3,858,829		4,167,616	
3.1	Teprica nga veprimtaria kryesore	1,884,499	(5,571,820)	5,977,072	
3.2	Teprica nga Publikimet	80,201	(1,700,000)	(388,776)	
3.3	Teprica nga kualifikimi AL & Kandidate	(419,916)	250,000	(944,986)	
3.4	Teprica nga depozitat e kursimeve	351,285	350,000	445,694	
3.5	Teprica nga kursi i kembimit	(102,449)		(21,849)	
Teprica total		(2,065,209)	(5,471,820)	2,327,620	
Teprica përfshirë Investimin AAM			(6,671,820)	1,066,080	
	Shpenzime për tarifen 7% për BMP		1,309,000	2,158,389	
Teprica total perfshire Investimin		(2,065,209)	(7,980,820)	(1,092,309)	

(1) Komente të përgjithshme mbi strukturën dhe analizën e buxhetit.

Në analizën e buxhetit do të bëhet një krahasim në vlerë absolute dhe në përqindje midis buxhetit të realizuar për periudhën 2019 me buxhetin e planifikuar dhe të miratuar nga Asambleja për këtë periudhë si dhe me buxhetin e realizuar në periudhën paraardhëse 2018. Në këto krahasime duhet të komentojmë si vijon.

Së pari, në buxhetin plan të miratuar nga asambleja për periudhën 2019 nuk janë përfshirë Shpenzimet e Amortizimit. KD ka propozuar të mos vendosen shpenzimet e amortizimit në parashikimin e buxhetit meqënëse nuk konsistojnë në daljen e mjeteve monetare. Gjithashtu, shpenzimet e planifikuara për aktivitetin udhëtim në fund të vitit nuk janë përfshirë në buxhet pasi ky shpenzim është miratuar në të njëjtën mbledhje të asamblesë ku është miratuar edhe buxheti si dy pika të ndryshme të rendit të ditës. Këto shpenzime arrijnë vlerën prej rreth 6,2 milionë Lekë (2018: 6,01 milionë Lekë), çka përbën një vlerë të rëndësishme në nivel absolut dhe mbi 2% të totalit të Përdorimeve.

Së dyti, në buxhetin e planifikuar të miratuar nga asambleja për periudhën 2019 ka pasur një gabim në llogaritjen e Tepricës Total si dhe Tepricës përfshirë Investimin, ku teprica total përfshirë investimin duhet të ishte paraqitur në vlerën 7 980 820 Lekë ashtu siç paraqitet në tabelën më sipër në këtë raport, ndërkohë që është miratuar nga Asambleja në vlerën 6 671 820 Lekë. Pra gjykojmë se tabela e buxhetit të planifikuar që është paraqitur në Asamble për miratim ka pasur gabime aritmetike në llogaritjen e totalit.

Sa më sipër, sugjerojmë të mbahen në konsideratë këto probleme gjatë leximit të komenteve për Burimet dhe Përdorimet në vijim të këtij raporti.

(2) Komente mbi Burimet.

Sikurse vihet re, Burimet financiare nga aktiviteti janë realizuar krahasimisht me parashikimin në masën 130%. Kanë ndikuar ndjeshëm në këtë rritje Të ardhurat nga kuota variabël e misioneve të cilat janë realizuar në masën 208% si dhe Të ardhurat nga regjistrimi i kandidatëve, të cilat janë realizuar në masën 380%, të cilat krahasimisht me një vit më parë janë planifikuar në 75% të realizimit të 2018, duke evidentuar rritje si në raport me planifikimin, edhe në raport me realizimin e një viti më pare. Rritja e të ardhurave nga regjistrimi i kandidatëve vjen si pasojë kryesisht e rritjes së tarifës së regjistrimit por edhe nga rritja e numrit të kandidatëve të regjistruar. Gjithashtu ka një rritje në nivelin 344% për të ardhura të tjera, por me një efekt jo thelbësor në vlerën absolute.

Ndërkohë, nga mosrealizimet nuk ka vlera thelbësore për tu theksuar nga pikëpamja absolute e vlerave, por vlen për tu përmendur mosrealizimi i Të ardhurave nga Botimet,

realizuar në nivel 10% të planifikimit, të cilat pritet të realizohen gjatë periudhës 2020 me përfundimin e përkthimit dhe rishikimit të materialeve të përditësuara të SNA-ve dhe Kodit të Etikës.

Në konkluzion të komenteve mbi Burimet, vërehet një tejkalim i realizimit të të ardhurave të IEKA-s, sidomos në të ardhurat e mbledhura nga anëtarësia nëpërmjet kuotës variabël. Kjo ka ardhur si pasojë e ndyshimeve të llogaritjes së kuotës variabël në këtë periudhë, e cila ka sjellë vështirësi edhe në planifikim.

Si një përmbledhje e kësaj analize, vërehet:

- **Realizim të të Ardhurave në 114%, krahasuar me 2018**
- **Realizim të të Ardhurave në 130%, krahasuar me buxhetin e planifikuar**

(3) Komente mbi Përdorimet.

Shpenzimet totale janë realizuar në krahasim me planifikimin në nivelin 98%, çka në një pamje të përgjithshme tregon një administrim të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm të aktiviteteve.

Ndërsa, nëse analizojmë një nga një zërat e shpenzimeve, kemi tejkalim të lehtë vetëm në dy zëra, shpenzimet për kualifikimin e kandidatëve, që vijnë si pasojë e ndryshimit të kurrikulës dhe përkojnë edhe me rritjen e të ardhurave nga ky zë, dhe një tejkalim për shpenzimet për investimet në nivel të papërfillshëm, ndërsa kryesisht ka mosrealizim në zërat e tjerë. Kështu, vërehet një realizim prej 72% i buxhetit të pagave dhe shpërblimeve të personelit administrativ (2018: realizim 63%), një realizim prej vetëm 36% të honorareve për komitetet, një realizim prej 22% i shpenzimeve për botime si dhe një mosrealizim edhe i shpenzimeve të administrimit, po të kihet parasysh çështja e shpenzimeve të amortizimit të trajtuara në paragrafin (II.ii.1) të këtij raporti.

Pra, si një përmbledhje e kësaj analize, vërehet:

- **Realizim të Shpenzimeve në 103%, krahasuar me 2018**
- **Realizim të Shpenzimeve në 92%, krahasuar me buxhetin e planifikuar (përfshirë vlerën e amortizimit)**
- **Një mosrealizim i buxhetit për shpenzimet e pagave, që mendojmë se do të stabilizohet për sa faza e rekrutimit të stafit ka përfunduar në tremujorin e fundit të vitit 2019.**

- **Një mosrealizim i buxhetit të komiteteve, kryesisht për shkak të mungesës së aktivitetit të tyre, si dhe**
- **Mosrealizim i buxhetit të botimeve, i cili pritet të realizohet në vitin 2020 në përputhje me të ardhurat.**

II.iii. KORREKTËSIA E LLOGARIVE TË APROVUARA NGA KD

Pasqyrat financiare të vitit 2019, të evidentuara më 31.12.2019 janë hartuar nga specialistja e Financës Valentina Sora dhe janë autorizuar nga Drejtori Ekzekutiv Elvira Hoxha. Pasqyrat financiare janë audituar nga Auditues Ligjor TPA Albania sh.p.k. me partner të auditimit Znj. Laura Gjinali në bashkëpunim me Auditues Ligjor, Znj. Rajmonda Reveli, të caktuar me këtë mision me Vendim Asambleje, të cilët arritën në datën 28 Maj 2020 në opinionin e pakualifikuar.

Pasqyrat financiare për vitin 2019 janë autorizuar nga Këshilli Drejtues, me Vendimin Nr. 34, datë 13.05.2020, dhe nënshkruar në emër të tij, nga Drejtori Ekzekutiv Znj. Elvira Hoxha dhe specialistja e Financës znj. Valentina Sora.

II.iv. KOMENTE MBI SITUATËN FINANCIARE

Sikurse mund të shihet edhe në Pasqyrën e Pozicionit të pasqyrave financiare, Aktivet të evidentuara arrijnë vlerën 119 446 787 Lekë (2018: 117 649 215 Lekë). Detyrimet në datën e bilancit janë 9 354 346 Lekë (2018: 6 464 465 Lekë), dhe Aktivet Neto të IEKA-s kanë vlerën 110 092 441 Lekë (2018: 111 184 750 Lekë).

Ka vend për tu komentuar rritja e detyrimeve, ku pjesën më të madhe, në vlerën 2,16 milionë Lekë, e përbën detyrimi ndaj BMP për tarifën 7%; si dhe një rritje e detyrimeve ndaj të tretëve në vlerën 159 572 lekë; të cilat janë shlyer gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2020.

Sikurse mund të shihet edhe në Pasqyrën e Burimit të Fondeve të pasqyrave financiare, Burimet e evidentuara kanë vlerën 30 378 299 Lekë (2018: 26 757 351 Lekë), përdorimet paraqiten në vlerën 27 726 837 Lekë (2018: 25 212 569 Lekë) dhe Deficiti Neto paraqitet 1 092 309 Lekë (2018: 2 065 211 Lekë).

Duke pasur në konsideratë parimet e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe pasqyrës së buxhetit, arrihet në konkluzionin se paraqitjet në Pasqyrën e

Aktivitetet e pasqyrave financiare 2019 përputhen me paraqitjet në Pasqyrën e Buxhetit faktik të periudhës 2019.

III. KONSTATIME DHE REKOMANDIME

- 1. Çështja e Komiteteve:** Duke gjykuar mbi buxhetin e shpenzuar por edhe mbi numrin e mbledhjeve të mbajtura dhe çështjeve të trajtuara, konstatohet se komitetet e krijuara sipas parashikimeve statutore nuk kanë realizuar të gjithë shumën e parashikuar në buxhet për funksionimin e tyre në ndihmë të përmbushjes së objektit të aktivitetit të IEKA-s.

Kështu, në këtë kuadër mund të përmendim mosfunksionimin prej disa vitesh të Komitetit të Kontrollit të Cilësisë. Duke qenë të vetëdijshëm për rritjen e rolit të BMP në këtë aspekt, përsëri vlerësojmë se për kontrollin e cilësisë është punuar dhe investuar ndër vite, dhe IEKA duhet të japë mesazhin se mund ta kryejë këtë funksion, pasi ka eksperiencën, metodologjinë dhe strukturat e duhura. Për këtë sugjerojmë punësimin sa më shpejt të inspektorëve të kontrollit të cilësisë në mënyrë që të rifillojë puna për kontrollin e zbatueshmërisë së standardeve profesionale dhe të kodit të etikës si dhe kontrollin e cilësisë për shërbimet e tjera.

Lidhur me komitetet e tjera, propozojmë të jenë më aktivë në realizimin e detyrimeve të tyre bazuar në rregulloret e funksionimit.

- 2. Çështja e botimeve:** Botimet janë mjaft të rëndësishme për edukimin e anëtarësisë por edhe për reputacionin dhe pozitën e IEKA-s në ambientin sfidues që është krijuar aktualisht. Për këtë arsye gjykojmë se është mjaft e rëndësishme të punohet më mirë dhe më shumë me qëllim nxjerrjen në botim të revistës të paktën 4 numra në vit. Gjithashtu, të punohet më shumë për botimin e të gjitha materialeve që publikohen nga IFAC dhe bordet e tjera të tij që kanë lidhje me profesionin, të cilat aktualisht janë dërguar në mënyrë elektronike.

- 3. Çështja e Debitorëve:** U konstatua se, në vijimësi, ka Debitorë (anëtarë të IEKA-s) që nuk kanë likuaduar detyrimet e tyre.

Detyrimi për kuotën variabël, krahasimisht me vitin 2018, është rritur për 1 501 879 lekë (2018: 6 118 128 lekë, ndërsa 2019: 7 620 007) shumë e cila përkon edhe me rritjen e të ardhurave nga kuota variabël. Megjithatë punën e bërë nga administrata mbeten akoma debitorë ndaj Institutit. Gjithsesi, duhet patur në konsideratë se regjistrimi i kuotës variabël bëhet mbi bazën e konstatimit dhe si pasojë arkëtimi i kuotës variabël që paraqitet në pasqyrat financiare bëhet gjatë vitit vijues.

Detyrimi për kuotën fikse dhe penalitetet paraqitet në zërin llogari të arkëtueshme. Ky zë ka rritje të detyrimit për AL me rreth 700 mijë lekë (2018: 2 649 770 lekë dhe 2019: 3 413 513 lekë) dhe është i pandryshuar detyrimi i papaguar nga AL pasivë (2018: 1 786 165 lekë dhe 2019: 1 750 915 lekë). Për këtë, sugjerojmë të bëhet analiza e debitorëve,

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2019

kush dhe sa janë anëtarët që nuk paguajnë dhe sa të vjetra janë detyrimet. Këtu nënvizojmë se, sjellja e anëtarëve debitorë nuk është korrekte jo vetëm me rregulloren e funksionimit të Institutit, por as etike në lidhje me anëtarët e tjerë që janë më se korrekt në këtë aspekt.

Ashtu si KKB paraardhës, edhe ne mendojmë se çdo anëtar i Institutit duhet të kryejë likuidimin e detyrimeve në pajtim me parashikimet statutores.

Sugjerojmë që lista e anëtarëve, me mbi dy vjet detyrime të papaguara, të përmenden me emër në Asamble.

KOMITETI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM



Elida MITI

Kryetar



Sokol TOSKA

Anëtar

Tiranë më, 6 Gusht 2020

IV. ORGANIGRAMA IEKA

ORGANIGRAMA E IEKAs

